

**RREGULLORJA E KËSHILLIT TË STUDENTËVE
TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Rregullorja bazohet në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, neni 99, dhe në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 125, pika 1 dhe 2, neni 127, dhe neni 129 deri në 134.

Betimi i Këshillit të Studentëve

Ne, përfaqësuesit e studentëve, betohemi të përfaqësojmë interesat e të gjithë studentëve; të promovojmë mirëkuptimin student/fakultet; të marrim pjesë në çështje të komunitetit që përfshijnë apo ndikojnë studentët tanë; por, mbi të gjitha, t'i inkurajojmë studentët që të përfshihen në veprimtaritë arsimore dhe shoqërore të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe të Universitetit të Tiranës.

KREU 1

EMRI, SYNIMI, QËLLIMET DHE PARIMET E KËSHILLIT TË STUDENTËVE

Neni 1

Përkufizimi

1. Ky organizim do të mbajë emrin Këshilli i Studentëve i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja; ai përfaqëson të gjithë studentët e çdo cikli në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (FGJH).
2. Këshilli i Studentëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (KSFGJH) është organizim i pavarur i studentëve të FGJH, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të FGJH në të gjitha programet e studimit.
3. KSFGJH përbëhet nga studentë të zgjedhur në mënyrë demokratike si përfaqësues të studentëve të FGJH, me qëllim që të përcjellë kërkesat e studentëve tek administrata e Fakultetit, dhe të kontribuojë në veprimtaritë arsimore në fakultet dhe në universitet.

Neni 2

Parimet

KSFGJH vepron sipas parimeve të mirëkuptimit dhe harmonisë ndërmjet anëtarëve, studentëve dhe administratës së FGJH.

Neni 3

Qëllimet

KSFGJH është organizim i pavarur i studentëve të FGJH, i cili nuk zhvillon veprimtari politike, ekonomike apo të tjera jo në përputhje me normat e Statutit të Universitetit të Tiranës dhe të etikës.

- a. Qëllimi thelbësor i KSFGJH është të sigurojë, si zhvillimin akademik, dhe atë shoqëror e personal të studentëve.
- b. KSFGJH garanton se mendimet dhe sugjerimet e komunitetit studentor përcillen në organet vendimmarrëse të FGJH dhe të Universitetit të Tiranës (UT) sipas rastit.
- c. KSFGJH promovon pjesëmarrjen e studentëve në veprimtaritë akademike, kërkimore dhe shoqërore që zhvillohen në FGJH dhe më gjerë.
- ç. Ajo mundëson një lidhje komunikimi ndërmjet administratës dhe studentëve, duke përfaqësuar konkretisht zërin e studentëve në fakultet.
- d. KSFGJH shpreh mendime dhe jep propozime për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me jetën studentore në FGJH dhe në UT, si; programet akademike, rregulloret, pjesëmarrja e studentëve

në programe kërkimore, organizimi i veprimtarive të ndryshme shoqërore, kulturore, artistike dhe sportive.

Neni 4 Detyrat

Detyrat kryesore të KSFGJH janë:

- a. Të diskutojë dhe të përpikt të gjejë zgjidhje për problemet studentore që mund të ngrihen;
- b. Të kontribuojë që studentët të jenë aktivë dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre organizuese dhe drejtuese;
- c. Të krijojë struktura të tilla që do të shërbejnë për informimin e vazhdueshëm të studentëve dhe për t'u kujdesur për ecurinë e tyre;
- ç. Të bashkëpunojë me këshillat studentorë nga fakultetet e tjera të UT apo universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizime të tjera studentore;
- d. Të bashkëpunojë me administratën e universitetit, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë akademike të mësimdhënies dhe të zhvillojë programe kërkimore shkencore;
- dh. Të krijojë dhe të ruajë marrëdhënie ndërmjet studentëve të FGJH dhe studentëve të fakulteteve të tjera të UT apo të fakulteteve të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit;
- e. Të zhvillojë shërbime të ndryshme që do të ndihmojnë në jetën studentore;
- ë. Të nxitë studentët që t'i përmirësojnë aftësitë akademike dhe kulturore;
- f. Të veprojë në përputhje me statutin e UT, rregulloret dhe dispozitat e tjera në fuqi.

KREU 2 RREGULLORET, KUJDESTARI I STUDENTËVE, VEPRIMTARIA, FINANCIMI, ZGJEDHJET, ORGANIZIMI

Neni 5 Rregulloret

KSFGJH mbështetet në legjislacionin shqiptar dhe në rregullat, kodet e rregulloret e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Neni 6 Kujdestari i studentëve

1. Kujdestari i studentëve caktohet një prej pedagogëve të FGJH, i cili zgjidhet nga KSFGJH dhe miratohet nga dekani.
2. Kujdestari i studentëve ka mandat 2-vjeçar dhe ka për mision përçimin e çdo problemi të studentëve tek autoritetet përkatëse, sipas kompetencës së tyre.
3. Nëse organi përkatës në FGJH nuk shprehet për këto probleme, kujdestari i drejtohet Rektorit të Universitetit. Çdo student, si gojarisht dhe me shkrim, i identifikuar apo në mënyrë anonime, ka të drejtë të vërë në lëvizje kujdestarin e studentëve, i cili detyrohet që të shënojë në një regjistër çdo shqetësim dhe zgjidhjen përkatëse që i është dhënë.
4. Në rast se KSFGJH konstaton se kujdestari i studentëve nuk zbaton si duhet detyrën e tij, i propozon dekanit zëvendësimin e tij.

5. Në mungesë të një kujdestari të studentëve, KSFGJH merr përsipër kompetencat e tij sipas këtij neni.

Neni 7

Veprimtaria

1. KSFGJH vepron brenda mjediseve të FGJH dhe i organizon mbledhjet e saj në salla të FGJH, në orare që nuk bien ndesh me oraret mësimore të asaj salle apo me oraret e veprimtarive të mundshme që zhvillohen në atë sallë. Në rast se zhvillimi i mbledhjes është i pamundur brenda mjediseve të FGJH, Kryetari i KSFGJH (në mungesë të tij, organizuesi i mbledhjes), përcaktojnë paraprakisht një vend jashtë mjediseve të FGJH me orarin përkatës për zhvillimin e mbledhjes.
2. Në rast se mundësohet nga infrastruktura e FGJH, si dhe me miratimin e autoriteteve përkatëse të FGJH, KSFGJH ka të drejtën e një apo disa zyrave të saj brenda fakultetit, si dhe për një infrastrukturë mbështetëse të veprimtarisë së saj.

Neni 8

Financimi

1. Veprimtaria e KSFGJH financohet dhe mbështetet nga buxheti i FGJH, në bazë të parashikimeve në buxhet.
2. Këshillat e Studentëve kanë të drejtë të krijojnë dhe fonde të tjera të ligjshme.

Neni 9

Zgjedhjet

1. KSFGJH ka mandat 2-vjeçar, dhe anëtarët e saj zgjidhen nga votat e të gjithë studentëve të FGJH.
2. Përgatitja për zgjedhjet e KSFGJH kryhet nga një Komitet i Zgjedhjeve Studentore (KZS), që ngrihet nga Kryetari i KSFGJH (më poshtë, Kryetari), dhe që ka në përbërje të tij studentë të KSFGJH, si dhe studentë të tjerë të FGJH sipas rastit.
3. Komiteti i Zgjedhjeve Studentore cakton datën, orën dhe vendin për zgjedhjet. Në çdo rast, zgjedhjet zhvillohen në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (përveç rasteve të jashtëzakonshme) dhe gjatë semestrit të dytë akademik.
4. Në bashkëpunim me autoritetet drejtuese të FGJH, KZS zbardh listat emërore të studentëve të FGJH. Në ditën e zgjedhjeve, çdo student votues konfirmon emrin në listat emërore përmes një dokumenti identifikues dhe nënshkruan përpara se të votojë.
5. Në përfundim të zgjedhjeve, KZS numëron votat dhe shpall kandidatët fitues.
6. Çdo person që ka statusin student në FGJH ka të drejtën të kandidojë për përfaqësues në Këshillin e Studentëve.
7. Çdo student ka të paktën një javë kohë për të dorëzuar kandidaturën për përfaqësues në KZS që nga çasti që dita e zgjedhjeve është shpallur nga KZS.
8. KZS jep informacionin për rregullore shtesë të zgjedhjeve.
9. Çdo kandidat mund të qarkullojë materiale fushate në përputhje me rregullat, kodet dhe rregulloret e FGJH dhe UT.
10. Kutitë e votave administrohen dhe numërohen nga KZS. Kandidatët dhe studentë të tjerë mund të jenë të pranishëm gjatë numërimit.
11. Kandidatët fitues shpallen dhe fitojnë statusin e përfaqësuesit menjëherë pas zgjedhjeve.
12. Përfaqësuesit e zgjedhur kanë mandat dyvjeçar, përveç rasteve kur largohen nga KSFGJH si pasojë e moskryerjes së detyrave të tyre, mungesës së zgjatur në mbledhjet e KSFGJH, si dhe në rastet kur japin dorëheqjen apo u përfundon statusi i studentit. Çdo përfaqësues ka të drejtën të rizgjidhet në zgjedhjet e tjera, përveç rasteve kur mandati i tij ndërpritet në mënyrë të parakohshme.
13. Në rast ndërprerjeje të parakohshme të mandatit të një përfaqësuesi, zhvillohen zgjedhje të parakohshme në grupin studentor të mbetur pa përfaqësues. Në rast se zgjedhjet e parakohshme nuk përfundojnë në zgjedhjen e një përfaqësuesi të ri, Kryetari ia ngarkon grupin studentor të

përfaqësuar një përfaqësuesi ekzistues të KSFGJH, gjersa të zgjidhet në mënyrë të suksesshme një përfaqësues i ri sipas kësaj pike.

14. Në grupet studentore të viteve të para të secilit cikël të FGJH, si dhe të viteve ku përbërja e klasave të FGJH pëson ndryshim madhor (siç është rasti i ndarjes së klasave në vit të tretë sipas profileve) zhvillohen zgjedhje çdo vit.

15. Lista e përfaqësuesve të KSFGJH publikohet dhe përditësohet rregullisht nga KSFGJH në internet dhe në stendat e informacionit në FGJH.

Neni 10 Organizimi

1. Çdo klasë ka përfaqësuesin e vet të zgjedhur në mënyrë demokratike, që e përfaqëson atë në Këshillin e Studentëve të FGJH.

2. KSFGJH zgjedh Kryetarin e vet. Kryetari ka të drejtën të caktojë një përfaqësues nga KSFGJH si Zëvendës Kryetar, si dhe ka të drejtën të ngarkojë përfaqësues të tjerë me funksione të caktuara sipas nevojës.

Neni 11 Mbledhjet

1. Përfaqësuesit e KSFGJH zhvillojnë mbledhje të rregullta të kryesuara nga Kryetari. Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjen e kryeson Zëvendës Kryetari.

2. Në rast se përfaqësuesi mungon më shumë se tri herë radhazi në mbledhjet e KSFGJH pa justifikim të arsyeshëm, ai përjashtohet nga KSFGJH.

3. Në rast mungese, përfaqësuesi ka të drejtë të caktojë një student nga klasa që përfaqëson për të marrë pjesë në mbledhje në emër të tij. Gjatë kësaj mbledhjeje, ky student ka të drejtat e plota të një përfaqësuesi.

4. Mbledhjet konsiderohen të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 30% e të gjithë përfaqësuesve. Përfaqësuesit e pranishëm plotësojnë një listë prezençe. Studentët e caktuar nga përfaqësuesit që mungojnë, shkruajnë dhe emrin e përfaqësuesit në listë.

5. Në fund të mbledhjes, hartohet një procesverbal, që përmban datën dhe vendin e mbledhjes, diskutimet e zhvilluara gjatë mbledhjes, vendimet e marra, dhe listën e prezencës bashkëngjitur.

Neni 12 Vendimet

1. Të gjitha vendimet në mbledhjet e Këshillit të Studentëve merren me shumicë të thjeshtë votash.

2. Në rast votash të barabarta, vota e Kryetarit jep vendimin përfundimtar.

3. Të gjitha vendimet hyjnë në fuqi në çastin kur nënshkruhen nga Kryetari

Neni 13 Detyrat

1. Detyrat e Kryetarit janë:

a. Të kryesojë mbledhjet e KSFGJH;

b. Të krijojë strukturën e KSFGJH në funksion të koordinimit dhe përmbushjes së qëllimeve të KSFGJH;

c. Të flasë zyrtarisht dhe të përcjellë mendimet e KSFGJH;

ç. Të veprojë si ndërmjetës midis KSFGJH dhe administratës së FGJH;

d. Të mbikëqyrë veprimtarinë e anëtarëve të KSFGJH;

e. Çdo detyrë tjetër që i përket normalisht këtij funksioni.

2. Detyrat e Zëvendës Kryetarit janë:

a. Të ndihmojë në mirëfunksionimin e KSFGJH, veçanërisht në veprimtaritë për të cilat ai është përgjegjës;

b. Të ndihmojë në koordinimin e veprimeve në projekte të ndryshme të KSFGJH;

c. Të kryejë detyra të tjera të caktuara nga Kryetari

Neni 14 **Hyrja në fuqi**

1. Ky Statut i Përkohshëm hyn në fuqi menjëherë pasi miratohet nga Këshilli i Studentëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

2. Statuti i Përkohshëm qëndron në fuqi derisa të hyjë në fuqi Statuti i Këshillit të Studentëve të Universitetit të Tiranës.

3. Sipas Statutit të Universitetit të Tiranës, neni 134, pika 1, pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, vihet në dijeni Dekani dhe administratori i FGJH.